



Funded by
the European Union



Zyra e Kryeministrit-UredPremijera-Office of the Prime Minister
Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje
/Office on Good Governance




KOSOVA
GJITHËPËRFSHIRËSE
INCLUSIVE KOSOVO|UKLJUČIVO KOSOVO

Viti | 2022

VIT I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Mundësi të Barabarta për të gjithë

KALENDARI I AKTIVITETET PËR VITIN 2022



“Kalendari i aktiviteteve për vitin 2022” është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e HandiKOS-it dhe ZQM-së dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.”



Funded by
the European Union



Zyra e Kryeministrit-UredPremijera-Office of the Prime Minister
Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje
/Office on Good Governance



KOSOVA
GJITHËPËRFSHIRËSE
INCLUSIVE KOSOVO|UKLJUČIVO KOSOVO

KOSOVA GJITHËPËRFSHIRËSE
PROJEKT I PËRKRAHUR NGA ZYRA E BE NË KOSOVË

VITI 2022

VIT I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Mundësi të Barabarta për të gjithë

KALENDARI I AKTIVITETET PËR VITIN 2022

Dhjetor, 2021.

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Personat me aftësi të kufizuara në Kosovë konsiderojnë se me gjithë veprimet që janë ndërmarrë viteve të fundit në përmirësimin e jetës, ata vazhdojnë të përballen me sfida të ndryshme në të gjitha aspektet jetësore të cilat ua pamundësojnë jetën me dinjitet dhe realizimin e të drejtave të tyre, që burojnë nga Kushtetuta dhe aktet tjera ligjore të Republikës së Kosovës.

Avancimi i standardeve të të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë arrihet duke siguruar përkushtimin dhe garantimin e Qeverisë, Kuvendit dhe Institucioneve vendore në përmirësimin e kuadrit ligjor për të drejtat dhe liritë të personave me aftësi të kufizuara.

Për tu arritur ky avancim, Kuvendi i Republikës së Kosovës më 3 Dhjetor 2020 – në Ditën Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara mbajti seanca Parlamentare lidhur me gjendjen e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, në të cilën deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës unanimisht miratuan Rezolutën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, përmes së cilës zotohen se:

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës deklaron përkushtimin për përmirësimin e kuadrit kushtetues dhe ligjor për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës.
2. Inkurajohen institucionet e autorizuara, që të propozojnë amendament kushtetues për përfshirjen e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si instrument ndërkombëtar i zbatueshëm drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.
3. Viti 2022, shpallet vit i personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës.

Krahas përmirësimin të kuadrit ligjor është tejet e rëndësishme edhe përfshirja e Konventës së OKB-së për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, krahas konventave të tjera. Kështu, Kosova do të avanconte në nivel kushtetues standardet e mishëruara në këtë Konventë, në bazë të së cilës përcaktohen detyrimet ligjore të shteteve nënshkruese për të promovuar dhe për të mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë gëzimin e plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore nga të gjithë personat me aftësi të kufizuara, dhe të promovojë respektimin e dinjitetit të tyre të qenësishëm. Kjo arrihet me inicim dhe propozim të institucioneve të autorizuara drejt Kuvendit të Republikës së Kosovës për amendamentin kushtetues për përfshirjen e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Po aq me rëndësi është edhe shpallja e vitit 2022 Vit i personave me aftësi të kufizuara, përgjatë të cilit do të ndërmerren hapat konkret në përmirësimin e situatës në të cilën gjenden Personat me Aftësi të Kufizuara. Lidhur me këtë Institucionet vendore së bashku me Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara, shoqërinë civile në bashkëpunim dhe koordinim të plotë do të zhvillojnë planin e aktiviteteve, i cili do të përfshij veprime konkrete dhe aktivitete të ndryshme sipas

çështjeve të cilat ndërlidhen drejtpërdrejt me avancimin e kushteve dhe standardeve të jetesës të Personave me Aftësi të Kufizuara të cilat do të realizohen gjatë vitit 2022. Po aq me rendësi, viti 2022 do të ketë për qëllim edhe ngritjen e vetëdijes së shoqërisë në përgjithësi në vendin tonë.

Me këtë hap Republika e Kosovës shpreh gatishmërinë dhe vullnetin politik, dhe ri-konfirmon përgjegjësinë që t'i respektoj dhe ti përmbushë obligimet ndërkombëtare të cilat sigurojnë realizimin e të gjitha të drejtave themelore, universale e të patjetërsueshme për të gjithë qytetarët në vend, si dhe të raportojë para mekanizmave ndërkombëtar për zbatimin e këtyre dokumenteve dhe politikave.

Definicioni i aftësisë së kufizuar sipas legjislacionit të Kosovës dhe konventës ndërkombëtare

Neni 1 i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) jep këtë definicion për personat me aftësi të kufizuara: "Personat me Aftësi të Kufizuara përfshijnë individët me dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale apo shqisore të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë".

Legjislacioni në fuqi në Kosovë jep këtë definicion: "Aftësia e kufizuar" është kufizimi i qasjes dhe kufizim i aktiviteteve të zakonshme në jetën e përditshme të një personi, si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore ose mendore, që e pengojnë atë për pjesëmarrje në aktivitetet e zakonshme ditore."

"Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2006) është e shkruar në 6 gjuhë (anglisht, frëngjisht, rusisht, arabisht, kinezisht dhe spanjollisht), ndërsa përkthimet në gjuhët e tjera duhet ta përdorin termin që është i pranueshëm nga vetë komuniteti i personave me aftësi të kufizuara. Përkthimi në gjuhën shqipe është bërë nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, dhe me këtë përkthim Konventa është e publikuar në ueb faqen e OKB-së.

Çfarëdo terminologjie tjetër për aftësi të kufizuara dhe persona me aftësi të kufizuara nuk është e pranueshme për personat me aftësi të kufizuara dhe as për organizatat që i përfaqësojnë ata/ato.

Veprimet e më poshtme të cilat kërkohen të ndërmerren nga institucionet qeveritare, parlamenti, Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara, shoqërinë civile dhe mediat.

Shëndetësia, Edukimi, Punësimi, Qasja, Mirëqenia Sociale, Kultura dhe Sporti janë disa nga çështjet dhe sfidat me të cilat në përditshmëri përballen Personat me Aftësi të Kufizuara në Kosovë që ndikojnë drejtpërsëdrejti në jetesën tyre, e të cilat janë identifikuar bazuar në raporte të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore. Me qëllim të avancimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara është përzgjedhur ndërhyrja me aktivitete dhe propozime konkrete, në këto çështje. Arsyet janë të shumta që janë cilësuar si të tilla.

1 – SHËNDETËSIA

Shërbimet shëndetësore të duhura, të qasshme dhe të përballueshme në nivelin primar, sekondar dhe terciar janë esenciale në barazimin e mundësive për personat me aftësi të kufizuara. Çdo person ka të drejtën e trajtimit shëndetësor të barabartë, kjo nuk nënkupton vetëm trajtimin nga ana e personelit shëndetësor por edhe lehtësimin e qasjes në shërbimet shëndetësore. Shërbime e tilla duhet të përfshijnë shërbime shëndetësore mjekësore dhe të infermierisë në kujdesin spitalor, ambulatorë apo në shtëpi të bazuar në komunitet, dhe në ndihmë shëndetësorë profesionale të specializuar. Personat me aftësi të kufizuar kanë të drejtën të gëzojnë standardin më të lartë të mundshëm shëndetësor pa diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, t’iu garantohen ato shërbime shëndetësore që u nevojiten, për shkak të aftësisë së tyre të kufizuar, duke përfshirë edhe identifikimin e hershëm dhe ndërhyrjen sipas rastit, si dhe shërbime të hartuara për të minimizuar dhe parandaluar përkeqësimin e aftësive të kufizuara, duke përfshirë fëmijët dhe të moshuarit; këto shërbime shëndetësore duhet t’iu garantohen sa më pranë të jetë e mundur komuniteteve të këtyre personave, përfshirë edhe zonat rurale; po ashtu duhet të kërkohet nga profesionistët e kujdesit shëndetësor të ofrojnë kujdes të së njëjtës cilësi për personat me aftësi të kufizuar si për të tjerët, si edhe të rrisin ndërgjegjësimin mbi të drejtat, dinjitetin, autonominë e njeriut dhe nevojave të personave me aftësi të kufizuar nëpërmjet trajnimeve dhe shpalljes së standardeve etike për kujdesin shëndetësor publik dhe privat për arsye sepse kur flitet për Personat me Aftësi të Kufizuara nevojat për shërbime shëndetësore janë më të shpeshta, më të nevojshme dhe më imediate dhe në këtë drejtim Personat me Aftësi të Kufizuara nuk marrin trajtimin shëndetësor të duhur.

2 – EDUKIMI

Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor dhe është e drejtë kushtetuese që institucionet publike të sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj, andaj fusha e edukimit si e tillë ka ndikim të madh në jetën e personave me aftësi të kufizuara. Institucionet duhet të respektojnë të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për arsim. Me qëllim të realizimit të kësaj të drejte pa diskriminim dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, duhet të garantohet një sistem arsimor gjithëpërfshirës. Personat me aftësi të kufizuara nuk duhet përjashtuar nga sistemi i arsimit të përgjithshëm për shkak të aftësisë së kufizuar, në veçanti fëmijët me aftësi të kufizuar të mos jenë të përjashtuar nga arsimimi pa pagesë, arsimi fillor, ose arsimi i mesëm, për shkak të aftësisë së kufizuar. Me qëllim që të garantohet realizimi i kësaj të drejte, Institucionet duhet të marrin masat e duhura për punësimin e mësuesëve, duke përfshirë mësuesit me aftësi të kufizuar të cilët janë më të kualifikuar që të arsimojnë fëmijët në gjuhën e shenjave dhe/apo alfabetin Brail, si dhe të trajnojnë profesionistët dhe stafin që punon në të gjitha nivelet arsimore. Trajnime e tilla duhet të përfshijnë ndërgjegjësimin në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe përdorimin e mënyrave të duhura njohëse dhe alternative, mjeteve dhe formateve të komunikimit, teknikave edukuese dhe materialeve për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara. Për këtë qëllim, Institucionet përkatëse do të garantojnë ofrimin e akomodimit të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuar.

3 – PUNËSIMI

E drejta e punës është një tjetër e drejtë e cila garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Me këtë të drejtë Personave me Aftësi të Kufizuara iu mundësohet zhvillimi i jetesës duke bërë punë të zgjedhur lirshëm apo të pranuar në tregun e punës dhe ambientin e punës që është i hapur dhe i arritshëm nga personat me aftësi të kufizuara. Aktualisht, punësimi i Personave me Aftësi të Kufizuara në vend është shumë i ulët, në këtë drejtim është tejet i nevojshëm hartimi dhe fuqizimi i politikave për rritjen e punësimit. Institucionet duhet të njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të punuar, njësoj si pjesa tjetër e popullsisë duke u siguruar që personave me aftësi të kufizuara u ofrohet një akomodim i arsyeshëm në ambientin e punës; për të promovuar programe për rehabilitim profesional për mbajtjen e vendit të punës dhe ofrimin e programeve për kthimin në punë për personat me aftësi të kufizuara. Po ashtu, duhet të mbrojmë dhe inkurajojmë realizimin e të drejtës për punë duke përfshirë dhe personat që e fitojnë aftësinë e kufizuar gjatë punësimit, duke marrë hapat e duhur duhet të evitojmë çdo lloj diskriminimi duke ju dhënë mundësinë e barabartë të gjithëve. Në Kosovë edhe pse është në fuqi Ligji për Aftësimin, Riaftësimin, Profesional dhe Punësim e Personave me Aftësi të Kufizuara, ai ende nuk po gjen zbatimin e duhur.

4 – QASJA

Qasja është parakusht për pjesëmarrje në shoqëri dhe në ekonomi. Në vendin tonë ekzistojnë pengesa të mëdha të cilat i pengojnë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë mundësitë e barabarta me qytetarët e tjerë. Me qëllim që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të mund të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, institucionet duhet të marrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara, ashtu si gjithë të tjerë të kenë qasje në ambientet fizike, në transport, informata dhe komunikim, duke përfshirë edhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në lehtësues apo shërbime të tjera të disponueshme apo të ofruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, duhet të përfshijnë ndër të tjera: ndërtesat, rrugët, transportin si në ambiente të brendshme ashtu edhe të jashtme, përfshirë shkollat apo vendet (ambientet) e punës. Në Republikën e Kosovës ekziston Udhëzimi Administrativ për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, dhe sikur ky Udhëzim Administrativ të ishte përfillur gjendja në teren do të ishte shumë më e favorshme për Personat me Aftësitë e Kufizuara.

5 – MIRËQENIA SOCIALE

Është obligim Ligjor njohja e të drejtës së personave me aftësi të kufizuara për një standard adekuat jetese për ta dhe për familjet e tyre, duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin e përshtatshëm si edhe të drejtën për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës duke ndërmarr hapat e duhura për të mbrojtur dhe përmirësuar realizimin e kësaj të drejtë pa diskriminim për shkak të

aftësisë së kufizuar. Po ashtu, edhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara thekson qartë obligimet e shteteve palë mbi njohjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për një standard adekuat jetese, përfshirë ushqimin, veshjen, strehimin, punësimin si dhe sigurimin e pensionit të cilat përbëjnë një standard dhe obligim ndërkombëtarë. Institucionet e pushtetit publik duhet të angazhohen për t'i garantuar secilit person mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton, në këtë mënyrë duhet të sigurohet mirëqenia sociale duke ju ofruar kushte të njëjta jetese sikur çdo qytetari të Republikës së Kosovës.

6 – KULTURA DHE SPORTI

Kultura dhe sporti luajnë rol tejet të madh duke ju mundësuar personave me aftësi të kufizuara të shoqërohen me bashkëmoshatarët, të jenë pjesë e ekipeve dhe aktiviteteve të ndryshme gjë që i bën të ndjehen të pa-diskriminuar. Për këtë arsye Institucionet vendore duhet njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë njësoj si gjithë të tjerët në jetën kulturore në vend si dhe të ndër marrin të gjitha masat e duhura për të garantuar që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë qasje në materialet kulturore në të gjitha formatet e arritshme për ta; të gëzojnë qasje në programet televizive, filmat, teatrot, dhe aktivitete të tjera kulturore; të gëzojnë qasje në institucionet të cilat ofrojnë shërbimet kulturore, si p.sh: teatrot, muzetë, kinematë, bibliotekat dhe shërbimet për turistët si dhe në monumentet dhe qendrat me rëndësi për kulturën kombëtare. Institucionet duhet të marrin masat e duhura për të bërë të mundur që personat me aftësi të kufizuar të kenë mundësinë për të zhvilluar dhe përdorur potencialin e tyre krijues, artistik, dhe intelektual, jo vetëm për të mirën e tyre, por gjithashtu për pasurimin kulturor të shoqërisë. Personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë të drejtën, njësoj si gjithë të tjerët, që tu njihet dhe të mbështetet identiteti i tyre specifik kulturor dhe linguistik, përfshirë dhe gjuhën e shenjave dhe kulturën e personave të shurdhër. Me qëllim që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë njësoj si gjithë të tjerët në aktivitetet argëtuese, rekreative dhe sportive, institucionet duhet të marrin masat e duhura për të inkurajuar dhe nxitur pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në aktivitetet sportive gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet; për të siguruar që të kenë mundësinë të organizojnë, zhvillojnë dhe marrin pjesë në aktivitete sportive specifike dhe argëtuese për aftësinë e kufizuar dhe për këtë qëllim, të inkurajojnë ofrimin e instruksioneve, trajnimit dhe resurset e duhura, njësoj si për të gjithë të tjerët. E drejta për të zhvilluar aktivitete të kulturës dhe sportit do të arrihet duke siguruar qasjen e personave me aftësi të kufizuara në terrenet sportive, argëtuese dhe turistike dhe duke siguruar qasjen e barabartë të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në lojëra, argëtime, aktivitete sportive dhe rekreative, përfshirë edhe aktivitetet që zhvillohen në sistemin shkollor.

7. DREJTËSIA DHE SIGURIA

Institucionet e drejtësisë duhet të sigurojnë qasje efektive në organet e drejtësisë për personat me aftësi të kufizuara njësoj si për pjesën tjetër të popullsisë, duke përfshirë akomodime të përshtatshme procedurale dhe sipas natyrës së aftësisë së kufizuar, me qëllim lehtësimin e rolit të tyre si pjesëmarrës direkt dhe indirekt, duke përfshirë edhe rolin e dëshmitarit, në të gjitha procedurat

ligjore, filluar nga fazat hetimore e deri në stade të tjera paraprake. Me qëllim që personave me aftësi të kufizuar tu bëhet e mundur qasja e duhur në organet e drejtësisë, Institucionet përkatëse duhet do të inkurajojnë organizimin e seancave të trajnimit për ata persona që punojnë në fushën e administrimit të drejtësisë, duke përfshirë policinë dhe personelin e burgut.

2. QËLLIMI – VITI 2022, VIT I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Me qëllim të avancimit të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, në Dhjetor 2020, Kuvendi i Kosovës aprovoj rezolutën me të cilën ndër të tjera mbështetjesh propozimi që viti 2022 të shpallet vit i personave me aftësi të kufizuara kurse gjatë vitit 2021, Kryeministri Albin Kurti konfirmoj dhe u zotua se me datën 3 Dhjetor 2021 edhe zyrtarisht do të bëjë shpalljen e vitit 2022, vit i personave me aftësi të kufizuara. Në të njëjtën kohë, nga Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara u kërkua që në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë relevante të hartojnë një plan të aktiviteteve të cilin do ta quajnë “Kalendari i aktiviteteve për Vitin 2022”.

Procesin për hartimin e “Kalendarit të aktiviteteve për vitin 2022” e morën përsipër ta zbatojnë Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) në përkrahje të Projektit “Kosova Gjithëpërfshirëse” i cili financohet nga zyra e BE në Kosovë.

Kalendari i Aktiviteteve për vitin 2022 bazohet në rezultatet e punës së përbashkët të përfaqësuesve të Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara si në vijim, HandiKOS, Shoqata e të Shurdhërve të Kosovës, Shoqata e të Verbërve të Kosovës, Down Sindrom Kosova, Autizmi dhe Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar, si dhe të përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë (MeSh), Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Ministrisë së Kulturës, Rinis dhe Sportit (MKRS), Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit dhe Infrastrukturës (MMPHI), Ministrisë së Drejtësisë (MeD) dhe Policisë së Kosovës (PK).

Me shpalljen e vitit 2022, vit i personave me aftësi të kufizuara Qeveria e Kosovës, Ministrinë dhe Organizatat e lartpërmendura synojnë të mobilizojnë resurset e tyre për të trasuar rrugën për një Kosovë pa pengesa dhe për të fuqizuar personat me aftësi të kufizuara në mënyrë që ata të mund të gëzojnë të drejtat e tyre dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha sferat e shoqërisë.

Objektivi gjatë vitit 2022 do të jetë që Kosova të përparojë drejt garantimit që të gjithë personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, pavarësisht nga gjinia, origjina racore ose etnike, feja ose besimi, mosha ose orientimi seksual të gëzojnë të drejtat e tyre njerëzore, të kenë mundësi të barabarta dhe qasje të barabartë për të marrë pjesë në shoqëri.

Kalendari i aktiviteteve për vitin 2022 merr parasysh diversitetin e aftësisë së kufizuar që përfshin dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore të cilat shpesh janë të padukshme, prandaj ky kalendar përmban një grup ambicioz të aktiviteteve në fusha të ndryshme dhe ka

prioritete të shumta të cilat me bashkëpunim të ngushtë në mes të institucioneve të Kosovës dhe organizatave që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara synohet të realizohen gjatë vitit 2022. Personat me aftësi të kufizuara do të jenë në qendër të vëmendjes gjatë Vitit 2022 i cili ka të bëjë edhe me ndërgjegjësimin për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për barazi të plotë dhe pjesëmarrje në të gjitha fushat. Bëhet fjalë për trajtimin e barrierave me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara, kudo që ato ndodhin. Viti 2022 ka të bëjë gjithashtu me ndërgjegjësimin se aftësia e kufizuar është një çështje shqetësuese për të gjithë ne.

3. AKTIVITETET PËR VITIN 2022 SIPAS KOMPONENTËVE

KOMPONENTËT

Kalendari i aktiviteteve ka shtatë komponentë të bazuara në rezultatet të cilat synohet të arrihen:

- Komponenti 1** – Shëndetësia
- Komponenti 2** – Edukimi & Arsimimi
- Komponenti 3** – Punësimi.
- Komponenti 4** – Qasja
- Komponenti 5** – Mirëqenia Sociale.
- Komponenti 6** – Kultura dhe Sporti.
- Komponenti 7** – Drejtësia dhe Siguria

Aktivitetet brenda secilës komponentë janë si në vijim:

KOMPONENTI 1 – SHËNDETËSIA

Legjislacioni

Veprimet të cilat do të ndermirën në fushën e legjislacionit lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për shërbimet cilësore shëndetësore:

- Ministria e Shëndetësisë i propozon Qeverisë së Kosovës të aprovoj aktin nënligjor, të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë për llojet e pajisjeve ndihmëse falas për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, që shërbejnë për lëvizje, parandalim dhe asistim, i cili bazohet në Ligjin për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik në Kosovë;
- Të krijohen kushtet për ofrimin e informatave në gjuhën e shenjave në institucionet shëndetësore;
- Ministria e Shëndetësisë në bashkëveprim me SHSKUK nxjerrin vendimin për themelimin e njësisë spinale për personat me lëndime spinale në kuadër të SHSKUK në Prishtinë;

AKTIVITETI 1.1.

Koha: Janar Dhjetor – 2022

- Të përditësohet lista e barnave esenciale me nevojat e propozuara nga Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK). Anëtarë të grupit punues për përditësim të listës esenciale të barnave të jetë një përfaqësues i OPAK.

Resurset e nevojshme:

Krijohet ekipi këshillues në përbërje të përfaqësuesve të personave me aftësi të kufizuara dhe zyrtarëve nga Ministria e Shëndetësisë të cilët organizojnë takime pune për të identifikuar barnat e nevojshme të cilat më pas vendosen në një listë e cila më tutje si propozim i dorëzohet grupit punues brenda Ministrisë së Shëndetësisë për ti përfshirë në listën esenciale të barnave.

AKTIVITETI 1.2.

Koha: Janar Dhjetor – 2022

- Në hyrje (receptione) të institucioneve shëndetësore (QKMF – Qendrat Kryesore të Mjekësisë familjare dhe Emergjencat në spitale regjionale dhe QKUK vendosen monitor të cilët ofrojnë informata në gjuhën e shenjave për personat e shurdhër si dhe sigurohet një numër telefoni kujdestarë i cili përmes “telefonave tabletë” ofron “online” shërbimet e interpretimit në gjuhën e shenjave në rastet kur personat e shurdhër i drejtohen institucioneve shëndetësore.

Resurset e nevojshme:

Shoqata e të Shurdhërve të Kosovës siguron interpretët e gjuhës së shenjave për të zhvilluar programin e videos –informuese i cili instalohet në monitorët informues kurse mjetet për blerjen dhe vendosjen e monitorëve sigurohen nga Ministria e Shëndetësisë. “Telefonat tabletë” për institucionet shëndetësore i siguron Ministria e Shëndetësisë kurse interpretët e gjuhës së shenjave i siguron Shoqata e të Shurdhërve të Kosovës.

AKTIVITETI 1.3.

Koha: Janar Dhjetor – 2022

- Repartet e Neonatologji/Gjinekologjisë në QKUK dhe të gjitha Spitalet Regjionale pajisen me aparate të cilat mundësojnë identifikimin e hershëm të pengesave në dëgjim / humbjen e dëgjimit. Aparatet mundësojnë ekzaminimet të foshnjat përmes aplikimit të metodave EOA (emetimet otoakustike) dhe RAATT (reagimi i automatizuar auditiv i trungut të trurit). Më shumë informata për ekzaminimet të cilat mundësojnë identifikimin e hershëm të vështirësive apo humbjes së dëgjimit të foshnjat mund ti gjeni në linkun në vijim:
<https://newborn-hearing-screening.com/>

Resurset e nevojshme:

Ministria e shëndetësisë mbulon shpenzimet për blerjen e aparateve të ekzaminimit dhe trajnimit të personelit shëndetësor të cilët do të përdorin të njëjtat. Më shumë informata, përfshirë specifikat dhe broshurën mbi aparatet “easyscreen” mund ti gjeni në linkun në vijim:

<https://www.maico-diagnostics.com/products/oea/easyscreen>

AKTIVITETI 1.4.

Koha: Janar Dhjetor – 2022

- Repartet e Gjinekologjisë në QKUK dhe spitalet regjionale pajisen me shtretër hidraulik për ekzaminime Gjinekologjike dhe Obstetrike të femrave me aftësi të kufizuara. Informata mbi qasjen pa pengesa në shërbime të tilla shëndetësore për femrat me aftësi të kufizuara mund të gjeni në linkun në vijim:

<https://nwadacenter.org/factsheet/accessible-medical-examination-tables-and-chairs>

Resurset e nevojshme:

Ministria e shëndetësisë mbulon shpenzimet për blerjen e shtretërve hidraulik dhe bënë shpërndarjen e tyre në QKUK dhe në spitalet regjionale.

AKTIVITETI 1.5.

Koha: Janar Dhjetor – 2022

- Të krijohet grup punues, i përbërë nga ministritë e linjës (përkatësisht MSH, MASHTI dhe MFPT), përfaqësues të shoqatave të PAK-ve si dhe grupe të tjera të interesit për të krijuar formulën e cila do të mundësonte financimin dhe shtrirjen e shërbimeve të vazhdueshme për personat me aftësi të kufizuara.

Koment: Ky aktivitetet është planifikuar edhe në “Ligjin Gjithëpërfshirës” prandaj nëse ligji aprovohet atëherë ky aktivitetet largohet nga kalendari.

KOMPONENTI 2 – EDUKIMI & ARSIMI

AKTIVITETI 2.1.

Koha: 3 dhjetor 2022

- Me qëllim të vetëdijesimit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, ora e parë e mësimit me datën 3 dhjetor (Dita Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara), nxënësit në arsimin fillor dhe të mesëm të ulet do të informohen mbi aftësinë e kufizuar dhe situatën e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në bashkëpunim me Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK) do të përpilojnë materialin prezantues në të cilin specifikohen çështjet kyçe mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara;

Materiali duhet të përfshijë llojet e aftësisë së kufizuar dhe specifikat e secilit grup, modelet (bamirësia, shëndetësore, sociale dhe modeli i të drejtave të njeriut).

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet që materiali i përgatitur për prezantim para nxënësve t'i përshtatet moshës së tyre.

Resurset e nevojshme: MASHTI në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) dhe shkollat

AKTIVITETI 2.2.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

- Të identifikohen 10 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta në 10 komuna dhe 5 shkolla të mesme të larta në 5 komuna që nuk kanë qasje fizike për fëmijët/nxënësit me aftësi të kufizuara dhe të ndërtohen pjerrinat për qasje.

Resurset e nevojshme:

MASHTI në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) përzgjedhë shkollat, harton projektin për ndërtime dhe bënë ndërtimin e pjerrinave.

AKTIVITETI 2.3.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

- Rriten kapacitetet për mësimin në Brail dhe "Orientim & Mobilitet" për fëmijët e verbër në shkolla. MASHTI punëson dy mësimdhënës për shkrimin e Brailit dhe Orientimit & Mobilitetit në Qendrën Burimore "Xheladin Deda" dhe përmes këtij angazhimi mbështetë fëmijët e verbër dhe gjysmë të verbër në gjithë Kosovën.

Resurset e nevojshme:

MASHTI në bashkëpunim me Qendrën Burimore "Xheladin Deda"

AKTIVITETI 2.4.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

- MASHTI inicion procesin për krijimin e Sintezës Vokale në Gjuhën Shqipe, duke mundësuar kështu që personat e verbër të mund të shfrytëzojnë tekstet digjitale sipas nenit 11 të Ligjit për të Verbër.

Resurset e nevojshme: MASHTI

AKTIVITETI 2.5.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

- Akreditimi i programit për shkrim në Brail dhe ofrimi i trajnime për mësimdhënës

Resurset e nevojshme: MASHTI, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), qendra burimore "Xheladin Deda"

AKTIVITETI 2.6.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

- 2.6.1. Rritja e numrit të asistentëve të punësuar në shkolla 100 asistentë të punësuar.
- 2.6.2. Punësimi i 3 (tre) asistentëve të gjuhës së shenjave në Qendrën Burimore “Nëna Terezë” në Prizren, për të mbështetur fëmijët me dëmtime në dëgjim.

Resurset e nevojshme: MASHTI në bashkëpunim me DKA dhe qendrat burimore

AKTIVITETI 2.7.

Koha: Qershor – Gusht 2022

- Zhvillimi i planit për ofrim të arsimit joformal në Qendrat Burimore për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.

Resurset e nevojshme: MASHTI në bashkëpunim me ekspertë, profesionistë të fushës si dhe përfaqësues të organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK)

AKTIVITETI 2.8.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

- Funkcionalizimi dhe ngritja e kapaciteteve të Ekipeve Vlerësuese Pedagogjike në komuna për specifikat e llojeve të aftësisë së kufizuara.

Resurset e nevojshme:

MASHTI bashkëpunon me OPAK në identifikimin e nevojave që lidhen me llojet e aftësisë së kufizuar.

AKTIVITETI 2.9.

Koha: Shkurt – Dhjetor 2022

- Hartimi i instrumenteve për identifikimin dhe vlerësimin e vështirësive në të nxënë nga psikologët në shkolla.

Resurset e nevojshme:

MASHTI në bashkëpunim me Departamentin e Psikologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe me mbështetjen e projektit të Këshillit të Evropës ‘INCLUDE’ zhvillojnë instrumentet, bëjnë pilotimin e tyre në shkolla dhe trajnimin e psikologëve të shkollave për përdorimin e tyre.

AKTIVITETI 2.10.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

- Akreditimi i gjuhës së shenjave si gjuhë e dytë amtare për mësime të mësimdhënësve që punojnë me nxënësit me dëmtime në dëgjim, prindërit dhe të tjerë që janë të interesuar të mësojnë gjuhën e shenjave.

Resurset e nevojshme:

MASHTI në bashkëpunim me Shoqatën e të Shurdhërve të Kosovës (SHKSH), ekspertë nga Finlanda dhe qendrën Burimore "Nënë Tereza", do të hartojnë standardin e gjuhës së shenjave si dhe materialet përcjellëse për akreditim.

AKTIVITETI 2.11.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

- Do bëhet akreditimi i kualifikimit (niveli i 5-të) Interpret i Gjuhës së Shenjave, me ç'rast MASHTI do të hartojë programin për këtë kualifikim që përfshin: standardin e profesionit, kurrikulat për lëndë, materialet mësimore dhe planin e realizimit.

Resurset e nevojshme:

MASHTI në bashkëpunim me akterët relevantë

AKTIVITETI 2.12.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

- Trajnimi i drejtorëve dhe mësimdhënësve të shkollave të arsimit të mesëm të lartë për qasjen dhe arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara. MASHTI bazuar në Kornizën për përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në shkollat e mesme të larta bënë trajnimin e drejtoreve për të rritur përfshirjen dhe orientimin dhe përgatitjen e nxënësve me aftësi të kufizuara për tregun e punës.

Resurset e nevojshme:

MASHTI në bashkëpunim me projektin e Këshillit të Evropës "INCLUDE".

AKTIVITETI 2.13.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

- Trajnimi i mësimdhënësve të 25 shkollave për qasjen dhe arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara.

Resurset e nevojshme:

MASHT në bashkëpunim me OPAK

KOMPONENTI 3 – PUNËSIMI

Legjislacioni

- Zbatimi i Ligjit dhe akteve Nënligjore për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuar. (Zbatimi i udhëzimit për vlerësimin a aftësisë së mbetur për punë për personat me aftësi të kufizuar si dhe krijimi/nxjerrja e UNIREF).

AKTIVITETI 3.1.

Koha: Shkurt – Qershor 2022

- Vendim i Kryeministrit i cili bazuar në ligjin për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuar obligon institucionet që gjatë vitit 2022 të plotësojnë kuotën për punësimin e PAK.
- Institucionet më pas kanë për detyrë të identifikojnë numrin e Personave me aftësi të kufizuara (PAK) të cilët janë të obliguar të punësojnë dhe duke bërë sistematizimin e vendeve të punës dhe re-organizimin e brendshëm caktojnë pozitat për të cilat shpallin konkurset dhe më tutje duke respektuar procedurat e vlerësimit punësojnë PAK.
- Ndermirën veprime për të siguruar qasje në institucione për të punësuarit me aftësi të kufizuara.

Aktiviteti 3.2.

Koha: Korrik 2014 – Shtator 2022

- Obligohet inspektorati i punës për inspektimin e zbatimit të ligjit nga ana e institucioneve për punësimin e PAK.

Resurset e nevojshme:

Ministria dhe inspektorati lëshojnë një qarkore për inspektorët!

KOMPONENTI 4 – QASJA

AKTIVITETI 4.1.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

4.1.1. Të rregullohet qasja fizike në objektet/qendrat për patentë shofer (ndërtesat ku organizohen provimet për tu pajisur me patentë shofer);

4.1.2. Brenda auto shkollave, të ketë edhe një automjet të qasshëm (me pajisje ndihmëse për vozitje) për personat me aftësi të kufizuara në tërë komunat e Republikës së Kosovës;

Grupi punues për hartimin e UA për licencimin për auto-shkolla të përfshijë edhe qasjen për personat me aftësi të kufizuara (në ndërtesë dhe automjete).

AKTIVITETI 4.2.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

4.2.1. Të furnizohet aeroporti i Prishtinës me karroca standarde që përdoren brenda aeroplanit për vendosje dhe zhvendosje të personave me aftësi të kufizuara, sikurse në çdo aeroport tjetër në rajon dhe më gjerë;

4.2.2. Zyra informuese për pasagjerë të pajiset me një tabletë (I-Pad) për komunikim me interpretuesin e gjuhës së shenjave (përmes kësaj pajisje kontaktohet shërbimi i interpretuesve të gjuhës së shenjave)

Resurset e nevojshme: Të gjitha shpenzimet do të mbulohen nga Aeroporti i Prishtinës.

AKTIVITETI 4.3.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

Trafiku ndër-urban, autobusët, të sigurojnë qasshmëri (të përshtatin autobusët me rampa/pjerrina, informim në audio) për Persona me Aftësi të Kufizuara;

AKTIVITETI 4.4.

Koha: Janar– Dhjetor 2022

• Në procesin e licencimit të përfshihet kriteri për operatorët e taksive të posedojnë së paku një veturë të qasshme (me rampë/pjerrinë) e cila u mundëson transportin edhe të personave me aftës të kufizuar;

Resurset e nevojshme:

MMPHI të dërgoj një qarkore te komunat për përfshirjen e këtij kriteri për licencimin e kompanive të taksive.

AKTIVITETI 4.5.

Koha: Janar– Dhjetor 2022

Në 5 Komuna të Kosovës do të identifikohen pengesat/barrierat dhe vlerësohet qasshmëria e një rrugë/ambienti të hapur apo sheshi, me dizajnë dhe kosto;

Resurset e nevojshme:

MMPHI dhe Komunat në bashkëpunim me Ministrin e Pushtetit Lokal

AKTIVITETI 4.6.

Koha: Janar– Dhjetor 2022

- Zhvillimi i sinjalistikës vizuale dhe auditive me qëllim udhëzimin e personit me aftësi të kufizuara intelektuale dhe autizëm.

Resurset e nevojshme: MMPHI në bashkëpunim me Komunitat

KOMPONENTI 5 – MIRËQENIA SOCIALE

AKTIVITETI 5.1.

Koha: Janar– Dhjetor 2022

- Ligji për kodin doganor dhe të akcizave të Kosovës, të përfshijë edhe shoqëruesit e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara të cilët nuk kanë mundësi të ngasin veturë dhe të ju mundësojë lirin nga importi dhe akciza për vetura për nevoja personale;

AKTIVITETI 5.2.

Koha: Shkurt – Qershor 2022

- Të lirohen nga dogana dhe akciza edhe automjetet të shoqatave të personave me aftësi të kufizuara të cilat janë të qasshme dhe të përshtatura për ofrimin e shërbimeve;

AKTIVITETI 5.3.

Koha: Korrik 2022 – Shtator 2022

- Projektligji për Vlerësimin, Njohjen e Statusit, Përfitimet dhe Shërbimet për Personat me Aftësi të Kufizuara, të aprovohet dhe fillojë zbatimin;

AKTIVITETI 5.4.

Koha: Shkurt –Qershor 2022

- Të ri formatohen dhe të ngritën kapacitetet e Komisioneve Vlerësuese për personat me aftësi të kufizuara;

Resurset e nevojshme:

AKTIVITETET E TJERA NGA KOMPONENTI 5

A/A	Data	Aktiviteti	Përgjegjësi
1.1	01 Mars-31 .06.2022	Aprovimi dhe zbatimi i Udhëzimit Administrativ i cili e rregullon strehimin rezidencial të personave të rritur me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendor. Ne të njëjtën kohë do të jenë të gatshëm edhe udhëzuesi dhe format e punës që do e ndihmojnë zbatimin e udhëzimit nga Institucionet ,OJQ-të e licencuara dhe nga sektori privat.	MFPT/Departamenti i Politikave sociale dhe familjes
1.2	01-maj-30-tetor 2022	Ndërtimi i dy shtëpive me bazë në komunitet, ku njëra do të jetë për strehim të personave të rritur me aftësi të kufizuara mendore dhe tjetra për strehim të fëmijëve të braktisur dhe me aftësi të kufizuara.	MFPT/Departamenti i politikave sociale dhe familjes
1.3	01.shkurt-01 qershor 2022-	Hartimi i Udhëzimit Administrativ për rregullat dhe procedurat për mbulimin e shpenzimeve për edukim dhe shëndetësi për fëmijët me aftësi të kufizuara. Ky udhëzim hartohet sipas ligjit 06/L -084 Për mbrojtje të fëmijës.	MFPT/Departamenti i politikave Sociale dhe familjes
1.4	01 janar – 30 qershor 2022	Dërgimi për aprovim në Qeveri i Ligjit për Vlerësimin, Njohjen e Statusit, Përfitimet dhe Shërbimet për AK	MFPT/zyra ligjore dhe Departamenti i politikave sociale dhe familjes
1.5	01 janar – mars 2022	Thirrja publike për mbështetje financiare të OJQ-ve të licencuara.	MFPT/Departamenti i politikave sociale dhe familjes

KOMPONENTI 6 – KULTURA DHE SPORTI

AKTIVITETI 6.1. SPORTI

Koha: Janar – Dhjetor 2022

6.1.1. Mbështetja e programeve sportive për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe përfshirja e sportit në arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

6.1.2. Trajnimi i instruktorëve të sportit për Personat me Aftësi të kufizuara (Organizatrat do të identifikojnë në Projekt Propozim për cilat sporte).

6.1.3. Sigurimi i pajisjeve sportive për sportet e personave me aftësi të kufizuara, përmes hartimit të një projekt propozimi

6.1.4. Inicimi i themelimi të garës së basketbollit në karroca (Me MKRS dhe Federatën e Basketbollit).

6.1.5. Përkrahja e organizimit të turnirit regjional të basketbollit në karroca (nga një ekip nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Kosova).

6.1.6. Pjesëmarrja e Personave me aftësi të kufizuara në lojërat paralimpike duke mbështetur programet trajnuese për sportistët.

Resurset e nevojshme: Departamenti i Sportit brenda MKRS

AKTIVITETI 6.2. TEATRI

Koha: Janar – Dhjetor 2022

6.2.1. Mbështetja e organizimit të një shfaqje teatrore në gjuhën e Shenjave;

6.2.2. Përfshirja e temës së aftësisë së kufizuar, në programin e Teatrit Kombëtar të Kosovës, përmes shpalljes së një konkursi për skenar teatrore me temën ngritja e vetëdijes për mundësi të barabarta për të gjithë.

Resurset e nevojshme: Departamenti i kulturës brenda MKRS

AKTIVITETI 6.3. MUZEU

Koha: Janar – Dhjetor 2022

6.3.1. Lehtësimi qasjes për personat me aftësi të kufizuara në institucionet e kulturës (muze, galeri, teatro, kinema, salla koncertesh dhe të tjera) dhe ndjekja e programeve të tyre përmes përdorimit të arritjeve të teknologjisë moderne;

6.3.2. Sigurimi i qasjes dhe pajisja e muzeumeve (muzeut Kombëtar të Kosovës) me monitorë informues në gjuhën e shenjave, nga ana e Ministrisë së Kulturës

6.3.3. Plotësimi dhe rishtypja e Katalogut të Muzeut Kombëtar të Kosovës në alfabetin Brail me imazhe taktile.

6.3.4. Pajisja e Muzeut Kombëtar me një monitor që informon për gjuhën shenjave. Monitorë propozohet të vendosen edhe në Kompleksin e LSHP-së dhe në Muzeun Arkeologjik në Prizren.

Resurset e nevojshme: MKRS

AKTIVITETI 6.4. NGRITJA E KAPACITETEVE

Koha: Janar – Dhjetor 2022

Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve për hartim, zbatim dhe menaxhim të projekteve të organizata dhe individëve me nevoja të veçanta për aplikim në fondet publike.

Resurset e nevojshme: MKRS

AKTIVITETI 6.5. BIBLIOTEKA

Koha: Janar – Dhjetor 2022

Funksionalizimi dhe mbështetja e bibliotekës për personat e verbër.

Resurset e nevojshme: MKRS

AKTIVITETI 6.6. FILMI

Koha: Janar – Dhjetor 2022

6.6.1. Organizimi i javës së filmit për Persona me Aftësi të Kufizuar (me temë aftësinë e kufizuar); Filmat ekzistues botëror me temë apo personazhe me aftësi të kufizuara shfaqen për 7 ditë në një kinema e cila ka qasje për personat me aftësi të kufizuara.

6.6.2. Shpallja e konkursit për skenarin e filmit dokumentar apo film të shkurtë me temë “Aftësinë e Kufizuar”.

6.6.3. Ministria e Kulturës si mbështetëse e “Dokufest” do ti rekomandoj drejtuesve të këtij festivali përfshirjen e filmave dokumentar me temë aftësinë e kufizuar.

Resurset e nevojshme: MKRS

AKTIVITETI 6.7. RINI

Koha: Janar – Dhjetor 2022

Mbështetja e aktiviteteve për të rinj me aftësi të kufizuara

6.7.1. Organizimi i një kampi për të rinj në të cilin do të bëhet prezantimi i kulturës së të shurdhërve dhe gjuhës së shenjave (me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse);

6.7.2. Mbështetja e aktiviteteve sportive në mes të rinjve me dhe pa aftësi të kufizuara;

6.7.3. Mbështetja e “Kuizit të diturisë” për të rinjtë me aftësi të kufizuara;

6.7.4. Mbështetja e Projekteve për industri kreative – artizanale;

6.7.5. Mbështetja e programeve të trajnimit për të rinjtë me aftësi të kufizuar;

Mbështetja e të rinjve me aftësi të kufizuar do të bëhet përmes programeve të trajnimit për ndërmarrësi dhe trajnimeve për “soft-skills”. Këto programe të trajnimit do të financohen nga MKRS.

6.7.6. Mbështetja e të rinjve me aftësi të kufizuara për vetëpunësim

Resurset e nevojshme:

Të rinjtë me aftësi të kufizuara do të mbështeten përmes grant-skemës që nëpërmjet përkrahjes financiare të ju mundësojë të rinjve të jetësojnë idetë dhe projektet e tyre inventive dhe t'i shndërrojnë ato në plane të arritshme që do të kenë ndikim në rritjen e punësimit të rinjve.

AKTIVITETI 6.8. PLAN I VEPRIMIT.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

Themelimi i grupit punues për hartimin e Planit të Veprimit për Kulturë, Rini dhe Sport për personat me Aftësi të Kufizuara. Gjatë vitit 2022 krijohet grupi punues në përbërje të përfaqësuesve të MKRS dhe Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara për të hartuar draftin e Planit pesë vjeçar të veprimit për KRS 2023-2027.

Resurset e nevojshme: MKRS në bashkëpunim me OPAK.

KOMPONENTI 7 – DREJTËSIA DHE SIGURIA

(Ministria e Drejtësisë)

AKTIVITETI 7.1.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

Hartimi i udhëzuesit informues për të drejtat e personave e aftësi të kufizuara në sistemin e drejtësisë. Ky aktivitet bëhet i pari / para organizimit të trajnimit në mënyrë që udhëzuesi do të prezantohet dhe shpërndalet në trajnim.

Resurset e nevojshme: Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me OPAK

AKTIVITETI 7.2.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

Trajnimi i stafit në Shërbimet Sprovuese dhe Korrektuese

Gjate vitit 2022 organizohet trajnimi, prezantohet udhëzuesi informues për të drejtat e Personave me aftësi të Kufizuara.

Resurset e nevojshme:

Materiali për trajnim hartohet së bashku me përfaqësuesit e MD dhe OPAK

AKTIVITETI 7.3.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

Mbrojtja ligjore e Personave me Aftësi të Kufizuara – Gjykatat, Prokurorët, (Kontaktohet Akademia e Drejtësisë për përfshirjen e një Moduli për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në programin e tyre të trajnimit).

Resurset e nevojshme: Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me OPAK.

AKTIVITETI 7.4.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara organizojnë një punëtori lidhur me veprimet të cilat duhet të ndërmerren në rastet kur nuk zbatohet ligji nga Institucionet publike/shtetërore.

Aktiviteti 7.4.1. Njohja e të drejtës së PAK për të shfrytëzuar të drejtat ligjore në baza të barabarta me të tjerët.

Aktiviteti 7.4.2. Informimi i personave të shurdhër për të drejtat e tyre ligjore.

Aktiviteti 7.4.3. Shërbimet te Noteri lidhur me autorizimin e personit të shurdhër (PAK)

Aktiviteti 7.4.4. Rregullimi i përdorimit të gjuhës së shenjave te Noteri

Resurset e nevojshme: Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me OPAK

AKTIVITETI 7.5.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

Ndërmarrja e masave për ti ofruar qasje PAK në mbështetjen e nevojshme për të ushtruar të drejtat e tyre ligjore.

Resurset e nevojshme: Ministria e Drejtësisë.

(Policia e Kosovës)

AKTIVITETI 7.6.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

Krijimi i grupit punues në mes të Shoqatës Kosovare të Shurdhërve dhe Policisë së Kosovës (IT ekspertët) për te gjetur modalitetet e kontaktimit te Policisë dhe numrave të tjerë emergjent nga personat e shurdhër.

(Të krijohet qasje për personat e shurdhër ne numrat emergjent si qendra e thirrjeve 112, policia 192, zjarrfikësit 193, ndihma e shpejte 194 dhe shërbimet publike 0800 12233)

AKTIVITETI 7.7.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

Të organizohet një takim pune (punëtori) në mes të përfaqësuesve të Policisë dhe Shoqatës Kosovare të Shurdhërve për hartimin dhe publikimin e informuesit për të shurdhëritë – lidhur me informimin për dënimet në komunikacion!

AKTIVITETI 7.8.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

Takim pune me divizionin e trajnimeve brenda Policisë për të ri-freskuar/ përditësuar të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në programin e trajnimeve të policëve.

AKTIVITETI 7.9.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

Konferencat e Policisë për media të nivelit kombëtarë të sigurojnë informimin në gjuhën e shenjave!

AKTIVITETI 7.10.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

Procedurat Standarde të Veprimit (PSV apo SOP) për rastet kur kryes të veprës janë personat me aftësi të kufizuara.

Krijohet grupi punues nga përfaqësuesit e Policisë dhe Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara për të hartuar PSV.

AKTIVITETI 7.11.

Koha: Janar – Dhjetor 2022

Ngritja e kapaciteteve të Policisë së Kosovës përmes Trajnimit të zyrtarëve të policisë për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave me aftësi të kufizuara dhe mbi specifikat e Personave me aftësi të kufizuara.

- Udhëzuesi hartohet para trajnimit

4. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara janë përgjegjëse ndaj Qeverisë së Kosovës, ndaj anëtarëve dhe mbështetësve të tyre, donatorëve dhe autoriteteve të ndryshme, si dhe ndaj përfituesve (personave me aftësi të kufizuara, jeta e të cilëve synohet të përmirësohet) prandaj të gjitha organizatat të cilat kanë kontribuar në hartimin e “Kalendarit të Aktiviteteve” në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe me përkrahjen e ekipit të Projektit “Kosova Gjithëpërfshirëse” mbështetur nga zyra e BE në Kosovë do të krijojnë një ekip për të monitoruar dhe raportuar lidhur me progresin e zbatimit të aktiviteteve të Kalendarit.

Në përbërje të ekipit do të jenë nga një përfaqësues i Organizatave të Personave me aftësi të kufizuara, një përfaqësues nga Zyra për Qeverisje të Mirë dhe një përfaqësues nga ekipi i Projektit “Kosova Gjithëpërfshirëse”.

Detyrë primare e ekipit monitorues do të jetë mbledhja sistematike dhe e vazhdueshme e informatave mbi progresin e zbatimit të aktiviteteve dhe identifikimin me kohë të pengesave (në rast se paraqiten) me qëllim që të propozojnë zgjidhje për tejkalimin e tyre.

Ekipi do të zhvillojë mekanizma të komunikimit të vazhdueshëm me përfaqësuesit e Ministrive relevante të cilat janë zotuar për të realizuar aktivitetet nga Kalendarit i vitit 2022 dhe do të ofrojë mbështetje në rastet kur kjo kërkohet.

Ekipi i monitorimit do të hartojë raporte 3 mujore të progresit si dhe një raport përfundimtar të cilin do t’ja dorëzojë Zyrës për Qeverisje të Mirë dhe më tutje Këshillit të Aftësisë së Kufizuar dhe zyrës së Kryeministrit.

ANEKS 1. TABELA E AKTIVITETEVE

AKTIVITETET 2022			
A/A	Periudha kohore	Aktiviteti	Përgjegjësi
Komponenti 1 – SHËNDETËSIA			
1.1.	Janar- Dhjetor 2022	Përditësohet lista e barnave esenciale me nevojat e propozuara nga Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK).	Ministria e Shëndetësisë dhe OPAK
1.2.	Janar- Dhjetor 2022	Vendosja e monitorëve në hyrje (recepzione) të institucioneve shëndetësore (QKMF – Qendrat Kryesore të Mjekësisë familjare dhe Emergjencat ne spitale regjionale dhe QKUK të cilët ofrojnë informata në gjuhën e shenjave	Ministria e Shëndetësisë dhe Shoqata e të Shurdhërve të Kosovës.
1.2.1	Janar- Dhjetor 2022	Sigurohet një numër telefoni kujdestarë i cili përmes “telefonave tabletë” ofron “online” shërbimet e interpretimit në gjuhën e shenjave në rastet kur personat e shurdhër i drejtohen institucioneve shëndetësore.	Ministria e Shëndetësisë dhe Shoqata e të Shurdhërve të Kosovës.
1.3.	Janar- Dhjetor 2022	Repartet e Neonatologji/Gjinekologjisë në QKUK dhe të gjitha Spitalet Regjionale pajisen me aparate të cilat mundësojnë identifikimin e hershëm të pengesave në dëgjim / humbjen e dëgjimit.	Ministria e Shëndetësisë
1.4.	Janar- Dhjetor 2022	Repartet e Gjinekologjisë në QKUK dhe spitalet regjionale pajisen me shtretër hidraulik për ekzaminime Gjinekologjike dhe Obstetrike të femrave me aftësi të kufizuara.	Ministria e Shëndetësisë
1.5.	Janar- Dhjetor 2022	Krijohet grup punues, i përbërë nga ministritë e linjës (përkatësisht MSH, MASHTI dhe MFPT), përfaqësues të shoqatave të PAK-ve si dhe grupe të tjera të interesit për të krijuar formulën e cila do të mundësonte financimin dhe shtrirjen e shërbimeve të vazhdueshme për PAK.	Ministria e Shëndetësisë
Komponenti 2 – EDUKIMI & ARSIMI			
2.1	03 Dhjetor 2022	Ora e parë e mësimi në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të ultë (Dita Ndërkombëtare e Aftësisë se Kufizuar) i kushtohet aftësisë se kufizuar	MASHTI, DKA Shkollat
2.2	Janar- Dhjetor 2022	Ndërtimi i pjerrinave në 10 shkolla fillore të mesme të ulëta dhe 5 shkolla të mesme të larta në 15 komuna	MASHTI, DKA
2.3	Janar- Dhjetor 2022	Punësimi i dy mësimdhënësve për Brail dhe “Orientim & Mobilitet” për fëmijët e verbër në shkolla	MASHTI
2.4	Janar- Dhjetor 2022	Inicimi i procesit për krijimin e Sintezës Vokale në Gjuhën Shqipe	MASHTI
2.5.	Janar- Dhjetor 2022	Akreditimi i programit për shkrim në Brail dhe ofrimi i trajnimeve për mësimdhënës	MASHTI, SHKSH, AKK, Qendra Burimore “Nënë Tereza”

2.6.	Janar- Dhjetor 2022	Punësimi i 100 asistentëve në shkolla për fëmijët me aftësi të kufizuara. Punësimi i 3 (tre) asistentëve të gjuhës së shenjave në Qendrën Burimore “Nëna Terezë” në Prizren, për të mbështetur fëmijët e shurdhër.	MASHTI, DKA, Qendrat Burimore
2.7.	Qershor - Gusht 2022	Zhvillimi i planit për ofrim të arsimit joformal në Qendrave Burimore për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.	MASHTI, Qendrat Burimore, OPAK
2.8.	Janar- Dhjetor 2022	Funksionalizimi dhe ngritja e kapaciteteve të Ekipeve Vlerësuese Pedagogjike në komuna	MASHTI, DKA, OPAK, Këshilli i Evropës
2.9..	Shkurt-dhjetor 2022	Hartimi i instrumenteve për identifikimin dhe vlerësimin e vështirësive në të nxënë nga psikologët në shkolla.	MASHTI, Departamenti i Psikologjisë (UP), DKA, shkollat, Këshilli i Evropës
2.10.	Janar- Dhjetor 2022	Akreditimi i gjuhës së shenjave si gjuhë e dytë amtare	MASHTI, SHKSH, Qendra Burimore “Nënë Tereza”, Këshilli i Evropës
2.11.	Janar- Dhjetor 2022	Akreditimi i kualifikimit (niveli i 5-të) për Interpret i gjuhës së shenjave	MASHTI, Këshilli i Evropës
2.12.	Janar- Dhjetor 2022	Trajnimi i drejtorëve dhe mësimdhënësve të arsimit të mesëm të lartë për qasjen dhe arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara.	MASHTI, DKA, Shkollat, Këshilli i Evropës
2.13.	Janar- Dhjetor 2022	Trajnimi i mësimdhënësve të 25 shkollave mbi qasjen dhe arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara.	MASHTI, DKA, Shkollat, Këshilli i Evropës
Komponenti 3 – PUNËSIMI			
3.1.	Janar- Mars 2022	Vendim i Kryeministrit i cili bazuar në ligjin për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuara obligon institucionet që gjatë vitit 2022 të plotësojnë kuotën për punësimin e PAK!	Zyra e Kryeministrit
3.2.	Janar- Dhjetor 2022	Obligohet inspektorati i punës për inspektimin e zbatimit të ligjit nga ana e institucioneve për punësimin e PAK.	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Komponenti 4 – QASJA			
4.1.	Janar- Dhjetor 2022	Inicimin e procedurës që Udhëzimi Administrativ 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara të shndërrohet në ligj;	MMPHI
4.1.1	Janar- Mars 2022	Nxjerrja e një qarkore nga ana e MMPHI e cila do të obligonte komunat për respektimin dhe zbatimin e UA 33/2007.	MMPHI

4.1.2	Janar- Mars 2022	Deri në hartimin e ligjit, MMPHI të kërkoj nga drejtorit komunale të urbanizmit që të krijojnë mekanizma për monitorimin e zbatimit të UA 33/2007.	MMPHI
4.2.1	Janar- Dhjetor 2022	Të rregullohet qasja fizike në objektet/qendrat për patentë shofer (ndërtesat ku organizohen provimet për tu pajisur me patentë shofer);	MMPHI
4.2.2	Janar- Dhjetor 2022	Brenda auto shkollave, të ketë edhe një automjet të qasshëm për personat me aftësi të kufizuara në tërë komnatat e Republikës së Kosovës;	Grupi punues për hartimin e UA për licencimin e auto-shkollave.
4.3.1	Janar- Dhjetor 2022	Të furnizohet aeroporti i Prishtinës me karroca standarde që përdoren brenda aeroplanit për vendosje dhe zhvendosje të personave me aftësi të kufizuara.	Departamenti i Aviacionit Civil
4.3.2	Janar- Dhjetor 2022	Zyra informuese për pasagjerë të pajiset me një tabletë (I-Pad) për komunikim me interpretuesin e gjuhës së shenjave.	Departamenti i Aviacionit Civil
4.4.	Janar- Dhjetor 2022	Trafiku ndër-urban, autobusët, të sigurojnë qasshmëri (të përshtatin autobusët me rampa/pjerrina, informim në audio) për Persona me Aftësi të Kufizuara;	MMPHI
4.5.	Janar- Dhjetor 2022	Në procesin e licencimit të përfshihet kriteri për operatorët e taksive të posedojnë së paku një veturë të qasshme (me rampë/pjerrinë) e cila u mundëson transportin edhe të personave me aftës të kufizuar;	MMPHI
4.6.	Janar- Dhjetor 2022	Në 5 Komuna të Kosovës do të identifikohen pengesat/barrierat dhe vlerësohet qasshmëria e një rrugë/ambienti të hapur apo sheshi, me dizajnë dhe kosto;	MMPHI
4.7.	Janar- Dhjetor 2022	Zhvillimi i sinjalistikës vizuale dhe auditive me qëllim udhëzimin e personit me aftësi të kufizuara intelektuale dhe autizëm.	MMPHI

Komponenti 5 – MIRËQENIA SOCIALE

5.1.	Janar- Dhjetor 2022	Ligji për kodin doganor dhe të akcizave të Kosovës, të përfshijë edhe shoqëruesit e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuar të cilët nuk kanë mundësi të ngasin veturë dhe të ju mundësojë lirin nga importi dhe akciza për vetura për nevoja personale;	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
5.2.	Janar- Dhjetor 2022	Të lirohen nga dogana dhe akciza edhe automjetet të shoqatave të personave me aftësi të kufizuar të cilat janë të qasshme dhe të përshtatura për ofrimin e shërbimeve;	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
5.3.	Janar- Dhjetor 2022	Projektligji për Vlerësimin, Njohjen e Statusit, Përfitimet dhe Shërbimet për Personat me Aftësi të Kufizuar, të aprovet dhe fillojë zbatimin;	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
5.4.	Janar- Dhjetor 2022	Të ri formatohen dhe të ngritën kapacitetet e Komisioneve Vlerësuese për personat me aftësi të kufizuar;	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Komponenti 6 – KULTURA DHE SPORTI			
6.1.1	Janar- Dhjetor 2022	Mbështetja e programeve sportive për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe përfshirja e sportit në arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.	MKRS – Departamenti i Sportit
6.1.2	Janar- Dhjetor 2022	Trajnimi i instruktorëve të sportit për Personat me Aftësi të kufizuara (Organizatat do të identifikojnë në Projekt Propozim për cilat sporte).	MKRS – Departamenti i Sportit
6.1.3	Janar- Dhjetor 2022	Sigurimi i pajisjeve sportive për sportet e personave me aftësi të kufizuara, përmes hartimit të një projekt propozimi	MKRS – Departamenti i Sportit
6.1.4	Janar- Dhjetor 2022	Inicimi i themelimi të garës së basketbollit në karroca (Me MKRS dhe Federatën e Basketbollit).	MKRS – Departamenti i Sportit
6.1.5	Janar- Dhjetor 2022	Përkrahja e organizimit të turnirit regjional të basketbollit në karroca (nga një ekip nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Kosova).	MKRS – Departamenti i Sportit
6.1.6	Janar- Dhjetor 2022	Pjesëmarrja e Personave me aftësi të kufizuara në lojërat paralimpike duke mbështetur programet trajnuese për sportistët.	MKRS – Departamenti i Sportit
6.2.1	Janar- Dhjetor 2022	Mbështetja e organizimit të një shfaqje teatrore në gjuhën e Shenjave;	MKRS – Departamenti i Kulturës
6.2.2	Janar- Dhjetor 2022	Përfshirja e temës së aftësisë së kufizuar, në programin e Teatrit Kombëtar të Kosovës, përmes shpalljes së një konkursi për skenar teatror me temën ngritja e vetëdijes për mundësi të barabarta për të gjithë.	MKRS – Departamenti i Kulturës
6.3.1	Janar- Dhjetor 2022	Lehtësimi qasjes për personat me aftësi të kufizuara në institucionet e kulturës (muze, galeri, teatro, kinema, salla koncertesh dhe të tjera) dhe ndjekja e programeve të tyre përmes përdorimit të arritjeve të teknologjisë moderne;	MKRS – Departamenti i Kulturës
6.3.2	Janar- Dhjetor 2022	Sigurimi i qasjes dhe pajisja e muzeumeve (muzeut Kombëtar të Kosovës) me monitorë informues në gjuhën e shenjave, nga ana e Ministrisë së Kulturës	MKRS – Departamenti i Kulturës
6.3.3	Janar- Dhjetor 2022	Plotësimi dhe rishtypi i Katalogut të Muzeut Kombëtar të Kosovës në alfabetin Brail me imazhe taktile.	MKRS – Departamenti i Kulturës
6.3.4	Janar- Dhjetor 2022	Pajisja e Muzeut Kombëtar me një monitor që informon për gjuhën shenjave. Monitorë propozohet të vendosen edhe në Kompleksin e LSHP-së dhe në Muzeun Arkeologjik në Prizren.	MKRS – Departamenti i Kulturës
6.4.	Janar- Dhjetor 2022	Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve për hartim, zbatim dhe menaxhim të projekteve të organizata dhe individëve me nevoja të veçanta për aplikim në fondet publike.	MKRS – Departamenti i Kulturës
6.5	Janar- Dhjetor 2022	Funksionalizimi dhe mbështetja e bibliotekës për personat e verbër.	MKRS – Departamenti i Kulturës
6.6.1	Janar- Dhjetor 2022	Organizimi i javës së filmit për Persona me Aftësi të Kufizuar (me temë aftësinë e kufizuar);	MKRS – Departamenti i Kulturës

6.6.2.	Janar- Dhjetor 2022	Shpallja e konkursit për skenarin e filmit dokumentar apo film të shkurtë me temë "Aftësinë e Kufizuar".	MKRS – Departamenti i Kulturës
6.6.3	Janar- Dhjetor 2022	Ministria e Kulturës si mbështetëse e "Dokufest" do ti rekomandoj drejtuesve të këtij festivali përfshirjen e filmave dokumentar me temë aftësinë e kufizuar.	MKRS – Departamenti i Kulturës
6.7.1	Janar- Dhjetor 2022	Organizimi i një kampi për të rinj në të cilin do të bëhet prezantimi i kulturës së të shurdhërve dhe gjuhës së shenjave (me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse);	MKRS – Departamenti i Rinisë
6.7.2	Janar- Dhjetor 2022	Mbështetja e aktiviteteve sportive në mes të rinjve me dhe pa aftësi të kufizuara;	
6.7.3	Janar- Dhjetor 2022	Mbështetja e "Kuizit të diturisë" për të rinjtë me aftësi të kufizuara;	MKRS – Departamenti i Rinisë
6.7.4	Janar- Dhjetor 2022	Mbështetja e Projekteve për industri kreative – artizanale;	MKRS – Departamenti i Rinisë
6.7.5	Janar- Dhjetor 2022	Mbështetja e programeve të trajnimit për të rinjtë me aftësi të kufizuara; (përmes programeve të trajnimit për ndërmarrësi dhe trajnimeve për "soft-skills").	MKRS – Departamenti i Rinisë
6.7.6	Janar- Dhjetor 2022	Mbështetja e të rinjve me aftësi të kufizuara për vetëpunësim	MKRS – Departamenti i Rinisë
6.8.	Janar- Dhjetor 2022	Themelimi i grupit punues për hartimin e Planit të Veprimit për Kulturë, Rini dhe Sport për personat me Aftësi të Kufizuara. Gjatë vitit 2022 krijohet grupi punues në përbërje të përfaqësuesve të MKRS dhe Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara për të hartuar draftin e Planit pesë vjeçar të veprimit për KRS 2023-2027.	MKRS dhe OPAK

Komponenti 7 – DREJTËSIA DHE SIGURIA

7.1.	Janar- Dhjetor 2022	Hartimi i udhëzuesit informues për të drejtat e personave e aftësi të kufizuara në sistemin e drejtësisë.	Ministria e Drejtësisë
7.2.	Janar- Dhjetor 2022	Trajnimi i stafit në Shërbimet Sprovuese dhe Korrektuese	Ministria e Drejtësisë
7.3.	Janar- Dhjetor 2022	Mbrojtja ligjore e Personave me Aftësi të Kufizuara – Gjykatat, Prokurorët, (Akademia e Drejtësisë përfshin një Moduli për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në programin e tyre të trajnimit).	Ministria e Drejtësisë
7.4.	Janar- Dhjetor 2022	Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara organizojnë një punëtori lidhur me veprimet të cilat duhet të ndërmerren në rastet kur nuk zbatohet ligji nga Institucionet publike/shtetërore.	Ministria e Drejtësisë
7.4.1	Janar- Dhjetor 2022	Njohja e të drejtës së PAK për të shfrytëzuar të drejtat ligjore në baza të barabarta me të tjerët.	Ministria e Drejtësisë
7.4.2	Janar- Dhjetor 2022	Informimi i personave të shurdhër për të drejtat e tyre ligjore.	Ministria e Drejtësisë
7.4.3	Janar- Dhjetor 2022	Shërbimet te Noteri lidhur me autorizimin e personit të shurdhër (PAK)	Ministria e Drejtësisë

7.4.4	Janar- Dhjetor 2022	Rregullimi i përdorimit të gjuhës së shenjave te Noteri	Ministria e Drejtësisë
7.5.	Janar- Dhjetor 2022	Ndërmarrja e masave për ti ofruar qasje PAK në mbështetjen e nevojshme për të ushtruar të drejtat e tyre ligjore.	
Policia e Kosovës			
7.6	Janar- Dhjetor 2022	Krijimi i grupit punues në mes të Shoqatës Kosovare të Shurdhërve dhe Policisë së Kosovës (IT ekspertët) për te gjetur modalitetet e kontaktimit te Policisë dhe numrave të tjerë emergjent nga personat e shurdhër.	Policia e Kosovës dhe OPAK
7.7	Janar- Dhjetor 2022	Të organizohet një takim pune (punëtori) në mes të përfaqësuesve të Policisë dhe Shoqatës Kosovare të Shurdhërve për hartimin dhe publikimin e informuesit për të shurdhëritë – lidhur me informimin për dënimet në komunikacion!	Policia e Kosovës dhe OPAK
7.8	Janar- Dhjetor 2022	Takim pune me divizionin e trajnimeve brenda Policisë për të ri-freskuar/ përditësuar të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në programin e trajnimeve të policëve.	Policia e Kosovës dhe OPAK
7.9	Janar- Dhjetor 2022	Konferencat e Policisë për media të nivelit kombëtarë të sigurojnë informimin në gjuhën e shenjave!	Policia e Kosovës dhe OPAK
7.10	Janar- Dhjetor 2022	Procedurat Standarde të Veprimit (PSV apo SOP) për rastet kur kryes të veprës janë personat me aftësi të kufizuara.	Policia e Kosovës dhe OPAK
7.11	Janar- Dhjetor 2022	Ngritja e kapaciteteve të Policisë së Kosovës përmes Trajnimit të zyrtarëve të policisë për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave me aftësi të kufizuara dhe mbi specifikat e Personave me aftësi të kufizuara.	Policia e Kosovës dhe OPAK
	3 Dhjetor 2022	Konferenca Vjetore	ZQM dhe OPAK

